

Intervistë me Robert Elsie

Kontaktet tuaja të para me Shqipërinë dhe shqiptarët kanë qenë në vitin 1978, çfarë kujtoni nga ajo periudhë?

Kanë kaluar tashmë 30 vjet që merrem me gjuhën dhe kulturën shqiptare. Nga kontaktet e para më kujtohet dashamirësia e shumë njerëzve edhe në Shqipëri edhe në Kosovë. Në atë kohë, pranimi i të huajve në mesin e shqiptarëve ishte një dukuri mjaft e rrallë, posi mbërritja e marinarëve të parë në një ishull të pazbuluar, larg Evropës, larg botës së njohur. Unë nuk dija pothuajse asgjë për shqiptarët në atë kohë, dhe shumica e shqiptarëve në Shqipëri nuk dinin asgjë për botën e jashtme. Gjendja ishte e vështirë për arsye të njohura politike. Prania e të huajve shkaktonte panik. Kuptohet se në Kosovë, ku isha për herë të parë në vitin 1979, kisha më shumë mundësi të komunikoja lirisht me njerëzit kur mësoja shqip. Prapë them se kudo, edhe në Prishtinë edhe në Tiranë kam hasur mikpritje.

E keni quajtur shqipen, “një nuse e bukur” dhe shqiptarizimin “gjaku im e nuk falet... d.m.th. kushdo, kurdo e kudo që të cenohen interesat mbarëshqiptare, ato duhen mbrojtur pa vonesë, menjëherë dhe rreptësisht”, këto fjalë tregojnë më së miri dashurinë tuaj për shqipen e shqiptarët, a mund të na thoni si ka lindur kjo dashuri?

Nuk me kujtohet që kam thënë një gjë të tillë dhe sigurisht nuk jam shprehur kështu. Mund të them përgjithësisht se shqiptarët nuk kanë ditur kurrë dhe sot nuk dinë të mbrojnë interesat e tyre dhe prandaj shpeshherë kanë dështuar. Një arsye e thjeshtë mund të jetë se interesimi i shqiptarëve në shumicën e rasteve përqendrohet në çështje lokale, rajonale, dhe jo në çështje mbarëkombëtare. Apo mos është prirja e shqiptarëve për të sabotuar njëri tjetrin?

Sipas meje, interesat shqiptare, apo mbarëshqiptare si të doni, duhet të mbrohen jo me flamur dhe pushkë si në të kaluarën dhe me fjalime nacionaliste, por me mençurinë dhe arsyetimin e një populli evropian i cili pas disa viteve do të hyjë në Bashkimin Evropian bashkë me popuj të tjerë të gadishullit.

Unë përpiqem sinqerisht të jap ndihmesën time për të mbrojtur interesat e shqiptarëve duke i prezantuar shqiptarët në botë, duke bërë që bota të kuptojë më mirë se kush janë shqiptarët dhe të ketë mirëkuptim për arritjet dhe për problemet e tyre. Këtë gjë e bëj kryesisht nëpërmjet botimeve të mia për Shqipërinë dhe për shqiptarët.

Gjatë 30 viteve të fundit kam botuar rreth 50 libra, shumica anglisht me temë shqiptare, për të paraqitur këtë popull, historinë, kulturën dhe letërsinë e tij. Shumë libra dhe artikuj të mi ndodhen tani në internet në faqen time www.elsie.de dhe mund të shikohen dhe lexohen aty falas.

Akademia e Shkencave të Maqedonisë, në të ashtuquajturën “enciklopedi” trillon dhe fyen shqiptarët, ku edhe pas vërejtjeve që i’u bënë, anëtarët e kësaj

Akademie, nuk e tërhoqën nga qarkullimi por vazhduan me të njëjtin ritëm. Sipas jush cila është kundërpërgjigja më e mirë që mund t'u japin shqiptarët, pavarësisht ku ndodhen?

Kam dëgjuar për skandalin e enciklopedisë maqedonase por nuk e kam lexuar, kështu që e kam të vështirë ta komentoj. Përgjithësisht them se kur ballkanasit shkruajnë histori, del një çorbë e cila shijohet vetëm nga bashkëkombësit e autorëve në fjalë. Ma merr mendja si është paraqitur historia dhe prania e shqiptarëve të Maqedonisë. Prandaj u takon shqiptarëve të bëjnë më shumë për prezantimin e tyre.

Keni marrë pjesë rregullisht në disa edicione të Seminarit Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare në Kosovë, si e vlerësoni këtë seminar dhe prurjet e tij?

Koha e fundit nuk kam qenë në Seminar kështu që nuk di se si zhvillohet. Për mua, them se rëndësia e Seminarit ishte si pikë takimi për albanologët dhe dashamirësit e gjuhës dhe kulturës shqipe në botë. Kur shkoja rregullisht, seminari më frymëzoi, më dha më shumë se një shtysë që të vazhdoja në rrugën e albanologjisë.

Dikur keni theksuar se ka mungesë të përkthyesve të mirë të letërsisë shqipe në gjuhën angleze, a ka ndonjë ndryshim në këtë aspekt?

Nuk ka ndonjë ndryshim këtu, sa di unë. Besoj se vetëm pas 10 viteve mund të vijë një brez njerëzish që përkthejnë mirë nga shqipja në anglisht. Por tani për tani, ka shumë pak njerëz në botën anglishtfolëse që kuptojnë mirë shqipen, dhe akoma më pak që dinë të përkthejnë.

Vetëm para pak kohësh është botuar një katalog me fotografi me ngjyra të shqiptarëve të 1913, kontribut edhe ky i juaj, megjithatë i dhatë ngjyra Shqipërisë të asokohe. Aktualisht a jeni duke përgatitur diçka të re, ndonjë projekt i ri?

Po, fotografitë e para me ngjyra në Shqipëri dhe në Kosovë të vitit 1913 ishin një zbulim tepër interesant. Më interesojnë fotografi të vjetra dhe, nëse më rastis të gjej koleksione të tjera, do të përpiqem t'i bëj të njohura. Shumica e koleksioneve që kam zbuluar deri tani mund të shihen në faqen time të internetit www.AlbanianPhotography.net

Koha e fundit kam përfunduar një projekt tjetër të madh albanologjik i cili sapo u botua në internet. Është fjala për një paraqitje të madhe të gjuhës shqipe, konkretisht për një prezantim të varianteve dialektore të gjuhës shqipe. Ky projekt përfshin deri tani 137 incizime zanore të të folmeve të shqipes nga 10 shtetet ku ajo flitet si gjuhë amtare. Incizimet në fjalë mund të dëgjohen nga çdo njeri në botë (dmth. nga çdo njeri që ka internet) në faqen time www.AlbanianLanguage.net

Së fundi, ju vë në dijeni për një roman të një autoreje shqiptare që e kam përkthyer në anglisht dhe i cili u botua gjatë kësaj jave. Vepra e autores Ornela Vorpsi, e cila jeton në Paris, quhet *The Country Where No One Ever Dies* (Vendi ku nuk vdiset kurrë). Është një libër i mrekullueshëm. Sapo doli nga shtypi pranë shtëpisë botuese Dalkey Archives në Shtetet e Bashkuara.

Ju falënderoj!

Intervistë me Brunilda Merko,

[Botuar në / Published in: *Bota Sot*, Prishtina, 3 nëntor/November 2009]